



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Inspektion  
Nr. 10 \_\_\_\_/2024

<b>Datë/Data</b>	09.07.2024
<b>Për/To/Za</b>	Bashkim RAMOSAJ- kryetar i Komunës
<b>Nga/from/Od</b>	Halil TOLAJ – Drejtor për Inspektion
<b>Tema/Subject/Subjekat</b>	RAPORT I PUNËS PËR PERIUDHEN JANAR-QERSHOR 2024

Drejtoria për Inspekcione gjate gjashtëmuorit të parë të vitit kalendarik 2024 kanë kryer punët dhe detyrat e punës të mbështetur në Ligjet, aktet nënligjorë, rregulloreve komunale me të cilat rregullohet puna e inspektorëve sipas fushave përkatëse, duke ju përmbajtur Planit të punës së Drejtoratit për vitin 2024.

Në Kuadër të drejtorisë për Inspektion janë sistemuar këta zyrtar:

Inspektori i Tregut,  
Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit që njëkohësisht është edhe shefe e inspektorëve  
Inspektori i Ndërtimit (me Kontratë mbi shërbimet e Veçanta),  
Inspektori i Veterinës (i angazhuar me kontratë mbi shërbimet e veçanta)  
dhe Zyrtarja Administrativë

Inspektorët përkatës sipas profesioneve të tyre kanë vepruar duke kryer inspektime( kontrolle mbikëqyrjeje) ndaj veprimtarive tregtare, ekonomike, në fushën e mjedisit, afatizimin e prodhimeve bujqësore si nga produktet qumështit dhe me prejardhje shtazore të mishit në duke synuar në atë të shëndetit publik, mjedisit, në ushtrimin e këtyre veprimtarive në pajtim me kërkesat e detyrueshme të përcaktuara në legjislacionin e Republikës së Kosovës;

Drejtoria e Inspektionit ka kryer inspektime të përbashkët me: Stacionin e Policisë, Komisionin për Miniera dhe Minerale, me Inspektoratin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës koordinim dhe bashkëpunim me drejtoritë e komunës ku këto inspektime kanë pasur për qëllim racionalizimin dhe koordinimin e veprimeve inspektuese

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN

№ i punës: 21494  
№ i listës: 02  
№ i detyrës: 09.07.24

09. Inspektionit

Gjithashtu inspektimet e planifikuara – janë inspektimet të realizuara sipas planit të punës dhe planit të monitorimit; Inspektimi i paplanifikuar ka përfshirë edhe procesin e inspektimeve i cili paraqitet ad-hoc dhe sipas nevojës pozitive zyrtare profesionale të inspektorit; Janë krye edhe inspektimi sipas kërkesave të personave fizik dhe juridik – janë inspektime të realizuara në bazë të paraqitjes së kërkesave;

Ri-inspektimi – është inspektimi përcjellës që kryhet gjatë dhe pas kalimit të afatit të caktuar nga inspektori lidhur me përmirësimin e urdhrave apo kërkesave për eliminimin e parregullsive të konstatuara gjatë inspektimit;

Këshilla inspektuese të subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të legjislacionit në fuqi dhe eliminimit të gjeturave subjekti inspektues si dhe marrjen e masave administrative dhe shqiptimit të gjobave që kanë për qëllim shmangien e rreziqeve që mund t'i shkaktohen shëndetit publik, sigurisë publike dhe mjedisit dhe interesave të ligjshme të personave fizikë dhe juridikë, të përcaktuara nga ligjet apo me ligje të veçanta.

Në kuadër të drejtorisë janë marr masa administrative nga zyrtarja që ka qenë përgjegjëse për lëshimin e fletëpagesave, taksave administrative, gjobave mandatorë përmes sistemit të Intranetit varësisht prej Ligjeve, Udhëzimeve Administrative dhe Rregullores Komunale në secilën fushë përkatëse të inspektimit. Duhet të theksohet edhe se janë kryer edhe punë tjera sipas fushe veprimtarisë të secilit nga inspektorët. Në tabelën në vijim po e prezantojmë aktivitetin e inspektorëve: **Tabela 1**

Pozita zyrtare	Inspektime në teren sipas detyres zyrtare	Inspektime sipas kërkesë-personave fizik dhe juridik	Aktivendime	Gjoha mandatorë	Kërkesa për gjykatë
Inspektorja për mbrojtje të mjedisit	38	78	6	16	6
Inspektori i tregut	40				
Zyrtarja administrative (asistime)	37				
Inspektori i ndërtimit	41				
Inspektori i Veterinës	31				
Gjithsej	187	78	6	16	6

**Kërkesë:** Si çështje e ndjeshme që është ndërtimi dhe cilësia e ushqimit (produkteve të qumështit dhe mishit) zgjidhja e çështja e inspektorëve të ndërtimit dhe veterinarëve është e domosdoshme.